

- Cila nga substancat e mëposhtme nuk është substancë e pastërt?
 - NaCl
 - $C_{12}H_{22}O_{11}$
 - Mg
 - Ajri
- Kur dy elemente bashkohen mes vete për të formuar komponime atëherë:
 - Ndryshojnë vetëm vetitë e njërit element
 - Vetitë e tyre mbeten të njëjta
 - Vetitë e tyre ndryshojnë
 - Nuk mund të formohen komponime kimike nga dy elemente që kanë veti të ndryshme
- Kalimi i një substance nga gjendja e ngurtë në të gazët quhet:
 - Avullim
 - Vlim
 - Sublimim
 - Kondensim
- Cila nga substancat e mëposhtme është përzierje?
 - Kripa
 - Sheqeri
 - Hekuri
 - Ajri**
- Cila nga përzierjet e mëposhtme është përzierje homogjene?
 - Uthulla
 - Përzierja e rërës dhe çimentos
 - Tymi
 - Përzierja e vajit dhe ujit
- Cila nga vetitë e mëposhtme nuk është veti fizike ?
 - Ngjyra
 - Tretshmëria
 - Djegia
 - Masa
- Cili nga elementet e mëposhtme është në gjendje agregate të lëngët?
 - Fe
 - Hg
 - O
 - C
- Cila nga vetitë e mëposhtme është e gabuar për dioksidin e karbonit: (C:12, O:16 g/mol)
 - Dioksidi i karbonit është gaz pa ngjyrë
 - Dioksidi i karbonit nuk është helmues
 - Dioksidi i karbonit është gaz pa erë
 - Dioksidi i karbonit është më i lehtë se oksigjeni
- Bërthama e atomit përmbanë:
 - Protone + neutrone
 - Protone + elektrone
 - Elektrone + neutrone
 - Vetëm protone
- Nëse numri i protoneve në bërthamën e atomit është 13 dhe numri i neutroneve është 12 , atëherë numri atomik i elementit është :
 - 13
 - 12
 - 25
 - 1
- Atomët që kanë numër të njëjtë të protoneve mirëpo numër të ndryshëm të neutroneve quhen:
 - Atome neutrale
 - Jone
 - Izotope
 - Izotone
- Sa shtresa elektronike (nivele energjetike) gjenden në mbështjellësin e atomit të Aluminit (Z=13)
 - 1
 - 2
 - 3
 - 4
- Llogaritni masën molekulare relative të H_2SO_4 nga masat atomike relative të hidrogjenit, $A_r(H)=1$ oksigjenit $A_r(O)=16$ dhe sulfurit $A_r(S)=32$
 - 98
 - 92
 - 103
 - 49
- Pozita e elementeve në Sistemin Periodik mvaret nga numri i:
 - Protoneve+elektroneve
 - Elektroneve
 - Protoneve
 - Neutroneve
- Elementet kimike në Sistemin Periodik janë të radhitura në:
 - 18 perioda dhe 9 grupe
 - 9 perioda dhe 18 grupe
 - 18 perioda dhe 7 grupe
 - 7 perioda dhe 18 grupe

16. Kur magnezi me numër atomik $Z=12$ liron 2 elektrone formohet joni pozitiv Mg^{2+} , sa elektrone gjenden në këtë jon?
- A) 12
B) 14
C) 10
D) 11
17. Lidhja kimike që formohet mes një metali dhe jometali quhet:
- A) Lidhje kovalente
B) Lidhje jonike
C) Lidhje metalike
D) Lidhje hidrogjenore
18. Në molekulën e fluorhidrikut (acidi fluorhidrik HF) kemi lidhje ($1H, 9F$):
- A) Jonike
B) Kovalente polare
C) Kovalente jopolare
D) Hidrogjenore
19. Sa është përqindja e masës në tretësirën e klorurit të kaliumit në qoftë se në 80g tretësirë janë tretur 2g klorur kaliumi?
- A) 2.5%
B) 7%
C) 10%
D) 40%
20. Komponimet e oksigjenit me elemente të tjera quhen:
- A) Kripëra
B) Acide
C) Baza
D) Okside
21. Cili nga pohimet e mëposhtme është i saktë:
- A) Komponimet e oksigjenit me metale quhen okside bazike
B) Komponimet e oksigjenit me jometale nuk quhen okside
C) Komponimet e oksigjenit me jometale quhen okside bazike
D) Komponimet e oksigjenit me metale quhen okside acidike
22. Cili nga oksidet e mëposhtme është oksid amfotern:
- A) CO
B) CaO
C) ZnO
D) SO₂
23. Cila prej vetive të poshtëshënuara është e gabuar për acidet:
- A) Japin jonine H^+ ne ujë
B) Mund të reagojnë me metalet amfoterike
C) Neutralizohen me baza
D) Letren e lakmusit e ngjyrosin në të kaltërt
24. Sa është vlera e numrit të Avogadros ?
- A) 6.02×10^{23}
B) 6.02×10^{23} mol
C) 2.026×10^{12}
D) 6.02×10^{13}
25. Sa e ka vlerën vëllimi molar I gazit në kushte standarde?
- A) 22.4 dm³
B) 24.4 dm³
C) 44.22 cm³
D) 22.4 cm³
26. Me rritjen e temperaturës, shpejtësia e reaksionit:
- A) Zakonisht rritet
B) Zvogëlohet
C) Mbetet konstante
D) Temperatura nuk ndikon në shpejtësi
27. Cili nga pohimet e mëposhtme është i saktë:
- A) Kur nje element liron elektrone formohen jone negative dhe elementi oksidohet
B) Kur një element pranon elektrone formohen jone positive dhe elementi reduktohet
C) Kur një element liron elektrone formohen jone negative dhe elementi reduktohet
D) Kur një element liron elektrone formohen jone positive edhe elementi oksidohet
28. Substanca e cila i liron elektronet njihet si:
- A) Mjet oksidues
B) Mjet reduktues
C) Katalizator
D) Inhibitor
29. Gjatë procesit të elektrolizës:
- A) Energjia kinetike shëndrrohet në energji mekanike
B) Energjia elektrike shëndrrohet në energji kimike
C) Energjia kimike shëndrrohet në energji elektrike
D) Energjia elektrike nuk ndryshon
30. Shumica e elementeve në Sistemin Periodik janë:
- A) Gjysmëmetale
B) Jometale
C) Gazëra ideale
D) Metale

31. Elementi me elektronegativitetin më të madh është
- Flori
 - Klori
 - Alumini
 - Natriumi
32. Reaksioni që zhvillohet gjatë elektrolizës së klorurit të natriumit është :
- $\text{NaCl} + \text{H}_2\text{O} \rightarrow \text{NaOH} + \text{HCl}$
 - $2\text{NaCl} + 2\text{H}_2\text{O} \rightarrow 2\text{NaOH} + \text{H}_2 + \text{Cl}_2$
 - $\text{NaCl} \rightarrow \text{Na}^+ + \text{Cl}^-$
 - $2\text{NaCl} + 2\text{H}_2\text{O} \rightarrow 2\text{NaOH} + 2\text{HCl}$
33. Kur acidet reagojnë me metale si Zn, Al dhe Cu produktet që përfitohen janë:
- Kripë + ujë
 - Vetëm kripë
 - Kripë metalike + hidrogjen I gazët
 - S'ka reaksion
34. Formula kimike e acidit hipokloror është :
- HClO_3
 - HCl
 - Cl_2O
 - HClO
35. Sa është numri oksidues i Fe në Fe_2O_3 , FeSO_4 dhe FeCl_3
- +3 , +2 , +3
 - +2 , +1 , +3
 - +3, +2, +2
 - +2, +3 , +3
36. Gjatë bashkëveprimit të natriumit me ujë lirohet:
- Oksigjeni dhe hidrogjeni
 - Acidi dhe hidrogjeni
 - Kripa dhe hidrogjeni
 - Baza dhe hidrogjeni
37. Elementi më I përhapur në korën e tokës pas oksigjenit është:
- Zinku
 - Ari
 - Silici
 - Azoti
38. Gjatë djegies së magnezit në prani të oksigjenit $\text{Mg(s)} + \text{O}_2(\text{g}) \rightarrow \text{MgO(s)}$, ndodhë:
- Oksidimi i magnezit
 - Reduktimi i magnezit
 - Oksidimi i oksigjenit
 - Oksidimi dhe reduktimi i magnezit
39. Cila nga metodat e mëposhtme përdoret për ndarjen e përzierjes të alkoolit dhe ujit ?
- Filtrimit
 - Kristalizimit
 - Dekantimit
 - Distilimit
40. Simboli kimik i bakrit është:
- Ba
 - Br
 - Cu
 - B
41. Hidrogjeni në laborator përfitohet duke vepruar:
- Në zink me bazë
 - Në zink me acid
 - Në baza me acide
 - Në acide me ujë
42. Kripa e gjellës përfitohet në zonat bregdetare me metodën e:
- Filtrimit
 - Sublimimit
 - Djegies
 - Avullimit
43. Si quhet reaksioni i bashkëveprimit të acideve me baza?
- Reaksion i acidifikimit
 - Reaksion i neutralizimit
 - Reaksion i oksidimit
 - Reaksion i përzierjes
44. Në 300g tretsirë të sheqerit 15% gjenden:
- 15g sheqer
 - 45g sheqer
 - 30g sheqer
 - 5g sheqer
45. Reaksioni I fotosintezës është reaksion:
- Egzotermik
 - Endotermik
 - Neutral
 - I kthyeshëm (reverzibil)
46. Si quhet ky komponim CuSO_4 ?
- Sulfati i bakrit
 - Sulfati i hekurit
 - Karbonati i bakrit
 - Fosfati i bakrit


47. Sa gram karbonat kalciumi ndodhen në 2 mol karbonat kalciumi (CaCO_3 , $\text{Ca}=40$, $\text{O}=16$, $\text{C}=12$)

- A) 100g
- B) 50g
- C) 80 g
- D) 200g

48. Sa është pjesëmarrja në masë e hidrogjenit në C_2H_6 ($\text{C}=12$, $\text{H}=1$)?

- A) 10%
- B) 20%
- C) 25%
- D) 40%

49. Barazoni dhe gjeni koeficientët e reaksionit të mëposhtëm :



- A) 1, 2, 1, 2
- B) 1, 1, 2, 1
- C) 2, 1, 1, 1
- D) 1, 2, 2, 1

50. Nëse 48 gram të magnezit reagojnë me acid klorhidrik sipas reaksionit : $\text{Mg} + \text{HCl} \rightarrow \text{MgCl}_2 + \text{H}_2$, sa do të jetë masa e hidrogjenit të liruar? ($\text{Mg}=24$, $\text{H}=1$)

- A) 1g
- B) 2g
- C) 4g
- D) 8g

mac
MEHMET AKIF
SCHOOLS